



**KONTRATE SHITBLERJE PASURIJE TE LUAJTESHME
PJESE KUOTASH TE SHOQERISE "S.M.O. UNION" sh.p.k., SHKODER**

Në Dhomen e Noterise Shkodër, dhe para meje noterit të këtij rrethi, Arben Salim Kopliku, me seli ne rrugen "Dos Bosko", karshi Gjykates se Faktit, Shkoder, sot me daten 12 gusht 2002(dymije), ditën e hene, u paraqiten personalisht palët e poshtëshenuara kontraktuesat:.....

Shitës : 1. Mehdi Sait Shabani, dtl. 1957, lind e banues në Shkoder.....

2. Ferdinand Enver Nuha, dtl. 1960, lind e banues ne Shkoder, lagje "Salo Halili", rruga "Ali Kelmendi", nr. 8, Shkoder.....

Blerës: Eduard Vehbi Mjeda, dtl. 20 shkurt 1969, lindur e banues ne Shkoder, lagja N. Gjylbegu, Shkoder.....

Të njohur prej meje si te tille, e me zotesi te plota juridike per te vepruar, me kërkesë të tyre, i redaktova këtë kontratë shitblerje pasurije të luajtëshme, pjese kuotash kapitali themeltar, si më poshtë vijon:.....

Ne baze te vendimit te Gjykatese se rrethit Tirane nr. 6190/2 6655 date 4 qershor 1999, palet kane rregjistruar Shoqerine "S.M.O. UNION", sh.p.k., Shkoder, shoqeri e cila eshte rregjistruar prane organit kompetent si person juridik, me objektin e ditur.....

Sipas mareveshjes se bere dhe me pare, z. z. 1. Mehdi Shabani, dhe 2. Ferdinand Nuha, i shesin z. Eduard Mjeda 33.3 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "S.M.O. UNION", sh.p.k., Shkoder, duke u bere keshtu bashkepronare, te tre se bashku, secili nga 33.3 %, ortakë pra dhe bashkeadministratore te kesaj firme.....

Ky akt u lidh me titull akt shitblerje pasurije te luajteshme, pjese kuotash te kapitalit themeltar, duke kryer dhe në të njëjten kohë, të gjithë veprimet pranë organeve kompetente...

Aktit i bashkelidhet dhe vendimi i sipertreguar i Gjykates se Tiranes.....

Kjo kontratë, pasi u lexue me zë të lartë para palëve kontraktuesat, të cilët, duke u gjetur konform kërkit dhe vullnetit të tyre të plotë, në prezencen time, e pranuan atë, dhe e nënshkruan si me poshte rezulton:.....

Palët kontraktuesat

Shitës

1. Mehdi Shabani 2. Ferdinand Nuha

Blerës

Eduard Mjeda

Noter

Arben Salim Kopliku